



Prishtinë, 04.04.2023

PËRGJIGJE NË KOMENTET E KOSTT NDAJ NJOFTIMIT

Përmbledhje

Pas njoftimit të dhënë nga ZRRE më datë 24.02.2022 për *Raportin e Monitorimit në lidhje me Blerjet e Energjisë Elektrike, Pagesat dhe Nominimet*, i licencuari ka pasur mundësi të paraqes komentet për një periudhë dy javore.

Brenda këtij afati, ZRRE ka pranuar komente nga KOSTT, të cilat i ka analizuar me kujdes dhe i ka paraqitur përmes këtij dokumenti propozimet përfundimtare lidhur me monitorimin e blerjeve të energjisë elektrike pagesat dhe nominimet për operatorin e sistemit të transmetimit (KOSTT).

Komentet e KOSTT si Përgjigje mbi njoftimin për shkelje të dhënë nga ZRRE-së

Faturimi dhe pagesat ndërmjet të Licencuarve

Të gjeturat e ZRRE-së:

KOSTT SHA., duke mos-vepruar me kohë në zbatimin e dispozitave përmbartimore sipas kontratës mes palëve, ka shkaktuar probleme financiare dhe ka rrezikuar stabilitetin financiar të KOSTT SH.A., e cila si kompani publike do duhej të reagoje me kohë.

Përgjigje e KOSTT

KOSTT sqaron se akumulimi i borxheve të papaguara ka ndodhur gjatë situatës së krijuar si pasojë e krizës energjetike ku qëndrimet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve për aktivizimin e procedurave përmbartimore janë bërë në konsultim dhe bashkërendim me Ministrinë e Ekonomisë me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të sektorit të energjisë në periudhën e krizës energjetike, sepse borxhet më të larta ishin nga KESCO, i cili furnizon rreth 99% të konsumatorëve në Republikën e Kosovës.

KOSTT ka adresuar me kohë në të gjitha takimet e mbajtura gatishmërinë për të inicuar procedurën përmbartimore për inkasim të borxheve nga KEDS/KESCO mirëpo, ri potencojmë se periudha në të cilën i referohemi ka qenë e jashtëzakonshme ku koordinimi për procese të tilla ka qenë i pashmangshëm me qëllim të evitimit të rëndimit të mëtejshëm të situatës energjetike në vend dhe sektorit të energjisë. Pas konsumimit të të gjitha modaliteteve në dispozicion, KOSTT pa vonesë ka inicuar procedurën përmbartimore në raport me borxhet e papaguara nga palët për periudha përkatëse, pavarësisht se ky proces nuk ka ndonjë ndikim efikas në evitimin e rrezikimit të stabilitetit financiar marrë për bazë afatet brenda të cilave vepron Gjykata. Gjithashtu, duhet theksuar se aktivizimi i procedurave përmbartimore nuk ka prodhuar asnjë efekt përveç rritjes së kostos së energjisë elektrike tek konsumatori fundor, gjë të cilën KOSTT e kishte parasysh dhe vazhdon ta ketë ende.



Gjatë gjithë kësaj periudhe KOSTT nëpërmjet takimeve dhe shkresave zyrtare ka bërë përpjekje të inkasojë detyrimet nga palët për obligimet e papaguara financiare dhe në fund ka aktivizuar edhe procedurën përbarimore dhe kalkulimin e interesit, për më shumë shihni komunikimin e bashkëngjitur.

Përgjigje e ZRRE-së në komentin e KOSTT

Lidhur me sqarimet e KOSTT, ZRRE rithekson se KOSTT në vazhdimësi ka filluar vitin me borxhe të akumuluar të palëve ndaj tij, dhe vitin 2021 ka filluar me borxhe 11.3 mil EURO të bartura nga viti paraprak dhe ka përfunduar vitin me borxhe të akumuluar të palëve ndaj tij në vlerë prej 53,5 mil EURO. KOSTT nuk ka filluar të zbatoj kushtet e marrëveshjes, përfshirë edhe përbarimin deri në maj të vitit 2022, gjë që ka lejuar vazhdimisht rritjen e borxhit dhe ai kishte arritur vlerën 61.84 mil EURO, dhe tanimë kompania veç ishte në vështirësi financiare. ZRRE edhe njëherë rithekson se përveç KESCO si furnizues me obligimin e shërbimit universal që kishte borxhe në vlerë 38.48 mil EURO, një borxh të lartë kishte edhe KEDS dhe atë në vlerë prej 21.28 mil EURO.

Prandaj ZRRE konsideron se KOSTT SHA., nuk ka vepruar me kohë në zbatimin e dispozitave përbarimore sipas kontratës mes palëve, duke shkaktuar probleme financiare dhe ka rrezikuar stabilitetin financiar të KOSTT SH.A., e cila si kompani publike do duhej të reagoje me kohë.

Të gjeturat e ZRRE-së:

KOSTT SHA., nuk ka zbatuar garancionin financiar, duke vepruar në pa-pajtueshmëri me Nenin 8 të Rregullave të Tregut dhe me Procedurën e Rregullave të Tregut për Garancion Financiar.

Përgjigje e KOSTT

KOSTT nuk pajtohet me konstatimin e ZRRE-së duke ritheksuar se:

- *Ka ekzistuar një dakordim verbal për moszbatim të garancionit financiar në takimet e përbashkëta të KOSTT dhe ZRRE për të shmangur rritjen e koston së energjisë për konsumatorët*
- *Procedura aktuale e garancionit financiar ka implikuar vlera shumë të mëdha të vlerës minimale të garancionit financiar, të papërbalueshme nga Palët Përgjegjëse për Balanc.*
- *Procedura aktuale e garancionit financiar ka vendosur kufizimin për institucionet bankare që të kenë vlerësim ndërkombëtar [B+]. Asnjëra nga bankat e licencuara në Kosovë nuk kanë qenë në gjendje të sigurojnë një vlerësim të tillë dhe*
- *ZRRE nuk ka qenë e gatshme që të miratojë amandamentimin e Procedurës së Garancionit financiar pas kërkesës së KOSTT në takimin e datës 08.07.2022 nën arsyetimin e dhënë përmes emailit më 13.07.2023 (i bashkëngjitur) se nuk është paraparë miratimi i amandamentimit në planin e punës të ZRRE-së për vitin 2022*



Përgjigje e ZRRE-së në komentin e KOSTT

ZRRE rithekson se nuk ka pasur ndonjë dakordim mes tyre dhe KOSTT do duhej ta zbatonte me kohë Procedurën e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiarë.

Sa i përket pretendimit të KOSTT se vlera minimale e garancionit financiar është e papërballueshme për Palët Përgjegjëse për Balanc, ZRRE ka dhënë komentet e veta dhe pajtueshmërinë për kalkulimin e vlerës së këtij garancioni. Poashtu ZRRE rithekson se procedurat të cilat rrjedhin nga Rregullat e Tregut do të duhej të amandamentoheshin me kohë, përfshirë edhe Procedurën Rregullave të Tregut për Garancionin Financiarë. KOSTT nuk ka amandamentuar këtë procedurë as pas aprovimit të rregullave të tregut në vitin 2018, prandaj në mungesë të kërkesës së KOSTT për amandamentimin e këtij dokumenti ZRRE nuk e ka përfshirë në planin e punës dhe si pasoj ka mbetur në fuqi Procedura Rregullave të Tregut për Garancionin Financiarë e aprovuar në vitin 2015.

Sa i përket pretendimit të KOSTT se ZRRE nuk ka qenë e gatshme që të miratojë amandamentimin e Procedurës së Garancionit financiar, duke ju referuar emailit të datës 13.07.2022, ZRRE rikujton se kërkesa e KOSTT për amandamentimin e Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiarë ka ardhur vetëm pas kërkesës eksplicite të ZRRE-së për aplikimin e këtij garancioni, me ç' rast KOSTT ka vërejtur edhe kërkesën që institucioni bankar ofruet i garancionit duhet të ketë vlerësim ndërkombëtar [B+] dhe pamundësinë së shumicës së bankave në Kosovë që të sigurojnë si të vetme vlera të mëdha të garancionit financiar.

Poashtu përmes këtij emaili ZRRE ka kërkuar nga KOSTT që përderisa procedura është në fuqi, kjo nuk e pengon Operatorin e Tregut të zbatoj dispozitat e përshtatshme në këtë procedurë që një palë tregtare të dëshmojë që ka Garancinë financiare dhe të përcaktoj vlerën e këtij garancioni dhe mjaftueshmërinë e tij, dhe ka kërkuar nga KOSTT që mos të ketë vonesa në përcaktimin dhe implementimin e këtij garancioni për palën tregtare dhe të veprojnë pa vonesa në përputhje me dispozitat e kësaj procedure.

Prandaj ZRRE konsideron se KOSTT SHA., duke mos zbatuar garancionin financiar, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 8 të Rregullave të Tregut dhe me Procedurën e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar.

Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit

Të gjeturat e ZRRE-së:

KOSTT SHA, nuk ka vepruar me Nenin 28, par.1 dhe Nenin 30, par. 1 të ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dispozitat e Nenin 2 par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut dhe Nenin 8 par.1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

Përgjigje e KOSTT



KOSTT nuk pajtohet me të gjeturën e ZRRE-së dhe konsideron se nuk ka bërë shkelje duke u bazuar në faktin se Ligji për Energjinë Elektrike (Neni 24, Neni 4) i jep të drejtë KOSTT që të blejë energji nga ndërmarrjet e tjera të energjisë të Palëve Kontraktuese të Energjisë me qëllim të arritjes së konkurrencës dhe plotësimit të kërkesës për energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetimit. Kurse sipas nenit 32 Paragrafi 3 të Ligjit për Energji Elektrike mes tjerash theksohet se *Tregtarët dhe furnizuesit e regjistruar në një Palë tjetër të Komunitetit të Energjisë kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut, rregullat e balancimit dhe rregullat fiskale.*

Gjithashtu referimi i ZRRE-së, se KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut nuk qëndron sepse nenet dhe paragrafët e cituar nga Rregullat e Tregut përcaktojnë kushtet për aderim në Rregullat e Tregut me Funksione Pjesëmarrëse të caktuara në Rregullat e Tregut e jo kushtet për lidhjen e Marrëveshjes Kornizë për Blerjen e Humbjeve.

Përgjigje e ZRRE-së në komentin e KOSTT

ZRRE konsideron se nuk janë relevante arsyetimet e dhëna nga KOSTT lidhur me tregtimin e energjisë elektrike me tregtarë të pa licencuar në Kosovë, apo tregtarët të cilët nuk kanë marrëveshje me vendin tonë për njohje reciproke të licencave sipas kërkesave ligjore.

Prandaj ZRRE rikujton KOSTT-in se bazuar në legjislacionin në fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund të ushtrohen vetëm me Licencë të lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike që janë të regjistruara në Kosovë, duke përfshirë edhe mundësinë që sipas parimit të reciprocitetit këto aktivitete të lejohen edhe pa Licencat e ZRRE-së për tregtarët të cilët kanë licenca në shtetet e tyre, e të cilat mund të njihen në Kosovë, sipas parimit të reciprocitetit, vetëm pasi të plotësohen kushtet e përcaktuara në Rregullën për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës nr 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Nga këto që u thanë më lartë, ZRRE rithekson se KOSTT nuk ka ofruar argumente relevante për t'i kundërshtuar të gjeturat në Raportin e ZRRE-së, andaj "KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e energjisë, nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, nenin 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike".

Blerjet e Energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në veri të vendit

Të gjeturat e ZRRE-së:

KOSTT SH.A, tregtimin e energjisë elektrike me KEK SH.A., për energjinë e pa-faturuara për pjesën veriore të Kosovës e ka bërë në shkelje të Nenit 22, par. 2 e 3 të ligjit për energjinë elektrike.

Përgjigje e KOSTT

1. KOSTT konsideron që konstatimi i ZRRE-së është i paqëndrueshëm për shkak që në rastet kur ka pasur buxhet të dedikuar për humbjet në veri:



– KOSTT ka tregtuar energji elektrike me KEK sh.a bazuar në marrëveshjen bilaterale për blerje të energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe humbjeve të sistemit (humbjet e veriut) si dhe Rekomandimin e ZRRE-së të 30.03.2017 për trajtimin e energjisë me shumicë (shih marrëveshjen e bashkëngjitur me amandamentimet përkatëse dhe rekomandimin e ZRRE).

– Shkelja e Nenit 22. Paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit për Energji Elektrike nuk qëndron sepse KOSTT ka kontratë bilaterale me KEK për blerjen e humbjeve në transmetim dhe veri e cila kontratë është bilaterale dhe amandamentohet për çdo vit.

2. KOSTT nuk pajtohet me të gjeturën nga Raporti i Monitorimit i ZRRE për shkak se Ligji për Energjinë Elektrike (Neni 24, Neni 4) i jep të drejtë KOSTT që të blejë energji nga ndërmarrjet e tjera të energjisë të Palëve Kontraktuese të Energjisë me qëllim të arritjes së konkurrencës. Referimi i ZRRE-së se KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut nuk qëndron sepse nenet dhe paragrafët e cituat nga Rregullat e Tregut përcaktojnë kushtet për aderim në Rregullat e Tregut me Funksione Pjesëmarrëse të caktuara në Rregullat e Tregut e jo kushtet për lidhjen e Marrëveshjes Kornizë.

Përgjigje e ZRRE-së në komentin e KOSTT

Dokumenti Përshkrimi i trajtimit të energjisë me shumicë dhe furnizim me shumicë i lëshuar nga ZRRE më 18 janar 2017 ka qenë për një periudhë tranzitore, deri më 31 mars 2018. ZRRE është e njoftuar se KOSTT dhe KEK kanë marrëveshje bilaterale për blerje të energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, por pas Aktvendimit të Gjykatës kompetente, kjo marrëveshje vlen vetëm për humbjet në transmetim dhe nuk mund të shfrytëzohet për të prokuruar energji për pjesën veriore të vendit.

Prandaj, ZRRE konsideron se tregtimi i energjisë elektrike mes KOSTT dhe KEK për energjinë e pafaturuar për pjesën veriore të Kosovës paraqet shkelje të Ligjit për energjinë elektrike, neni 22, paragrafi 2 dhe 3.

Poashtu, gjatë këtij procesi të prokurimit të energjisë për mbulimin e konsumit në veri të vendit, nga importi, KOSTT ka tregtuar me kompani të palicencuara dhe ashtu siç është cekur më lartë nuk ka vepruar në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, respektivisht nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e energjisë, nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, nenin 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

Devijimet e sistemit në raport me rrjetin interkonektiv

Të gjeturat e ZRRE-së:

1. KOSTT SH.A., ka bërë shkelje duke mos shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e paraparë me kodin e balancës, nenit 2.5.1.1. për të parandaluar shfaqjen e mungesës së energjisë (masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë



kërkesën totale), por ka kaluar direkt në mekanizmin e fundit duke urdhëruar KEDS-in që të aplikoj reduktim të ngarkesës në rrjetin e shpërndarjes.

Përgjigje e KOSTT

KOSTT konsideron se gjatë periudhës kohore të cekur, bazuar në raportimet pas operative, ka vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin dhe procedurat në fuqi, konkretisht Ligjin për Energji nr. 05/L-81 Neni 25, Udhëzimin Administrativ UA Nr.04/2017, Kodin e Balancit Neni 2.5.1.1, Kodin Operativ Neni 6.1.1 dhe 6.12.1 dhe Neni 2.5.1.1.

KOSTT thekson se gjatë periudhës në fjalë ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë balancuese në dispozicion, por ishte e pamundur që të mbuloi gjithë deficitin e ndodhur, i shkaktuar kryesisht nga jobalancet e palëve tregtare KESCO, KEDS, KEK, dhe konsumimit të energjisë elektrike në veriun e Kosovës të pa kontraktuar paraprakisht, me ç'rast tërheqjet nga rrjeti interkonektiv arrinin vlerën deri rreth 40% të konsumit nacional.

KOSTT poashtu sqaron se në rrethanat tjera nuk është përgjegjës për mbulimin e konsumit të nominuar në vend të palëve tregtare dhe siguron produktet për balancimin e sistemit në kohë reale (brenda ditës D), në kohëzgjatje maksimale 8 orë në ditë, të cilat duhet t'i përdor në rastet e jobalancave të paqëllimshme, në rastin e daljes pa plan të ndonjë njësie gjeneruese apo devijimeve të paqëllimshme të palëve tregtare ndaj programeve paraprakisht të nominuara.

Në gjendjen emergjente të shpallur nga Qeveria e Kosovës, KOSTT e mban të drejtën e aplikimit të reduktimeve të konsumit bazuar në Udhëzimin Administrativ UA Nr.04/2017 Neni 4.5, Neni 5.4, Ligji për energji nr.05/L-081 Neni 25, deri sa Ministria e Ekonomisë, pas aprovimit të rekomandimit të Komitetit Teknik Emergjent (KTE) nxjerr vendimin për implementimin e planit të masave kufizuese në furnizim.

Përgjigje e ZRRE-së në komentin e KOSTT

Ashtu siç ishte cekur në raportin fillestarë dhe përgjigjet e ZRRE-së, KOSTT nuk ka ofruar argumente lidhur me zbatimin e masave kufizuese në furnizim me energji duke zbatuar reduktime për datat 22-23 dhjetor 2021, kur nuk ka qenë ende e shpallur gjendja emergjente. Për më tepër, sa i përket këtyre ditëve, KOSTT nuk ka dërguar dëshmi që ka zbatuar plotësisht Kodin e Balancit paragrafi 2.5.1.1. ku thuhet: a) Kur ekzistojnë situata të tilla që e bëjnë të pamundur parandalimin e mungesës së energjisë, masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë kërkesën totale.

Referuar emailit të KOSTT të datës 27.09.2022 drejtuar ministrisë përkatëse, si dhe shkresën 2396 të datës 01.12.2022 drejtuar ministres së Ekonomisë, KOSTT konfirmon se në situatat emergjente të energjisë elektrike, KOSTT në cilësinë e operatorit të sistemit dhe të tregut angazhon të gjitha rezervat balancuese në disponim sipas dispozitave kontraktuale që i ka, mirëpo në situatën emergjente nuk mund të bëhet Shkyçja e Konsumit pa Vendim nga Ministria përkatëse (Neni 4.1 i Udhëzimit Administrativ nr. 04/2017), ku ka potencuar se vendimi i Ministrisë së Ekonomisë për aplikimin e shkyçjeve të konsumit në rastet e pamjaftueshmërisë së furnizimit është i domosdoshëm për balancimin e Zonës Rregulluese të KOSTT, në kuadër të Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale.

Prandaj ZRRE konsideron se pasi Ministria e Ekonomisë nuk ka nxjerrë vendim për kufizim të furnizimit me energji (reduktim), KOSTT do të duhej të zbatonte ligjin deri në nxjerrjen e këtij vendimi dhe mos të zbatoj kufizime në furnizim.



Në takimet e mbajtur mes ZRRE dhe KOSTT lidhur me reduktimet, KOSTT në vazhdimësi ka mbajtur qëndrimin se duhet të reduktoj ngarkesën edhe pa vendimin e ministrisë përkatëse duke mos shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e paraparë me kodin e balancës për të parandaluar shfaqjen e mungesës së energjisë (masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë kërkesën totale), dhe ka kaluar direkt në mekanizmin e fundit duke kërkuar nga qendra dispeçerike e KOSTT të urdhëroj KEDS-in që të aplikoj reduktim të ngarkesës në rrjetin e shpërndarjes.

Prandaj ZRRE mbetet në qëndrimin se, KOSTT ka bërë shkelje duke mos shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e paraparë me kodin e balancës, nenit 2.5.1.1. për të parandaluar shfaqjen e mungesës së energjisë (masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë kërkesën totale), po ka kaluar direkt në mekanizmin e fundit duke urdhëruar KEDS-in që të aplikoj reduktim të ngarkesës në rrjetin e shpërndarjes

Të gjeturat e ZRRE-së:

- 1. KOSTT SH.A, ka vepruar në shkelje të Nenit 9 të Kontratës për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurim e Frekuencës e lidhur me KESH si Palë Ofruese e Shërbimit (POSH), duke ndikuar në kostot e operimit të KOSTT SH.A. e rrjedhimisht edhe të konsumatorët fundor, pasi që një kosto e tillë e mFRR, është kosto që njihet me aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale të KOSTT SH.A. konform Nenit 12 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT-së.*

KOSTT konsideron që konstatimi i ZRRE-së është i paqëndrueshëm me arsyetimin si në vijim, si dhe deklaron se Nëse nuk arrihet që të aktivizohet energjia mFRR atëherë kostoja transferohet në devijimet e paqëllimshme që prapë është kosto që duhet të njihet:

- Në rastet kur Pala Ofruese e Shërbimit (në këtë rast KESH) ka dështuar të ofrojë shërbimin atëherë me automatizëm ajo është Palë Përgjegjëse për Balanc në Zonën ku operon (në Shqipëri) e kurrsesi në Kosovë (nëse nuk e ka të nënshkruar Marrëveshjen për Palën Përgjegjëse për Balanc në Kosovë).
- Çfarëdo pamundësi e aktivizimit të rregullimit FRR nga Zona Rregulluese e Kosovës shkakton kosto të devijimit në Zonën Rregulluese të Kosovës dhe sipas mekanizmit balancues në fuqi kostoja transferohet te Palët Përgjegjëse për Balanc vetëm në Kosovë (nuk ka mundësi të jetë ndryshe).

Përgjigje e ZRRE-së në komentin e KOSTT

Bazuar në të dhënat e dërguara nga KOSTT për periudhën raportuese, në disa raste Pala Ofruese e Shërbimit (POSH) ka dështuar të siguroj energjinë e deklaruar për aktivizimin e mFRR, me ç'rast janë shkaktuar devijime ndaj sistemit interkonektiv. Sipas Kontratës për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës mes palëve KOSTT dhe KESH si POSH, respektivisht neni 9, në rast se POSH i mFRR dështon të aktivizoj në tërësi ose pjesërisht kapacitetin e deklaruar paraprakisht dhe të kërkuar nga KOSTT, atëherë POSH i mFRR i nënshtrohet përgjegjësisë së mekanizmit balancues në zonën LFC ku ai operon.

Ashtu siç edhe është paraqitur në raportet e KOSTT lidhur me aktivizimin e mFRR si dhe sipas deklarimeve në takimin e mbajtur më 30.01.2023, në disa raste KOSTT nuk ka zbatuar nenin 9 të kontratës mFRR duke marrë përsipër edhe kostot e devijimeve të shkaktuara nga mosrespektimi i aktivizimit të mFRR nga ana e POSH.



ZRRE nuk ka pranuar ndonjë dëshmi/faturë nga KOSTT ku shihet se në periudhën monitoruese KOSTT ka ngarkuar kostot e devijimit ndaj interkoneksionit si rezultat i mos respektimit të marrëveshjes nga ana e POSH.

Andaj, ZRRE mbetet në qëndrimin se KOSTT SH.A, ka vepruar në shkelje të Nenit 9 të Kontratës për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurim e Frekuencës e lidhur me KESH si Palë Ofruese e Shërbimit (POSH), duke ndikuar në kostot e operimit të KOSTT SH.A. e rrjedhimisht edhe të konsumatorët fundor, pasi që një kosto e tillë e mFRR, është kosto që njihet me aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale të KOSTT SH.A. konform Nenit 12 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT-së.

Të gjeturat e ZRRE-së:

1. *KOSTT SH.A., me aktivizimin e mFRR për nevoja të balancimit të sistemit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të Nenit 13 par.2 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT-së.*

Përgjigje e KOSTT

Që nga 14 dhjetor 2020 e deri më sot KOSTT e ka bërë aktivizimin e mFRR vetëm për nevoja të balancimit të sistemit e kurrsesi për ndonjë nevojë tjetër, në përputhshmëri të plotë me Nenin 13 paragrafi 2 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT-së.

Rezerva për Restaurim të Frekuencës sipas paragrafit 1.5 të Rregullave të Tregut është e definuar si shërbim ndihmës për Restaurim të Frekuencës, ndërsa sipas Kodit të Operimit të ENTSO-E Rezerva Restauruese e Frekuencës definohet si rezervë e fuqisë aktive e disponueshme për të rivendosur frekuencën nominale dhe në rastin kur Zona Sinkrone përmban më shumë Zona Rregulluese për të rivendosur programin paraprakisht të aprovuar.

Shërbimi ndihmës për Restaurim të Frekuencës është shërbim që aktivizohet për restaurim të frekuencës e rrjedhimisht vetëm për balancim të sistemit.

Duhet cekur se mFRR mund të përdoret në situatat kur ka humbje të papritur të gjenerimit si dhe pamjaftueshmëri të gjenerimit dhe importit në përmbushjen e kërkesave për energji elektrike në sistem.

Derisa mFRR shpesh aktivizohet si përgjigje ndaj humbjes së papritur të gjenerimit, gjithashtu mund të përdoret në situata kur ka energji elektrike e pamjaftueshme në disponim për të mbuluar kërkesën në kohë reale. Në të dy rastet, aktivizimi i mFRR është i nevojshëm për të rivendosur frekuencën e rrjetit në limitet e përcaktuara si dhe programin paraprakisht të aprovuar të shkëmbimit me interkoneksionin.

Përgjigje e ZRRE-së në komentin e KOSTT

Bazuar në Kodin e Balancit, neni 4.4.4.2 “... Rezerva e rregullimit terciar përdoret për të kompensuar si humbjen e gjenerimit ashtu edhe humbjen e ngarkesës...”. ZRRE ka analizuar të dhënat e dërguara nga KEK për rëniet e njëjësive gjeneruese dhe ka krahasuar ato me të dhënat e KOSTT dhe vërehet se KOSTT në disa raste ka aktivizuar rezervën edhe kur nuk ka pasur rënie të njëjësive gjeneruese, por është aktivizuar për nevojat e balancimit të sistemit.

KOSTT në përgjigjen e tij, bazuar në Kodin e Operimit të ENTSO-E, konsideron mFRR si rezervë për balancim të sistemit, edhe pse sipas kodit të balancit në fuqi, ashtu siç është cekur më lartë, Rezerva e rregullimit terciar përdoret për të kompensuar si humbjen e gjenerimit ashtu edhe humbjen e



ngarkesës, ka shfrytëzuar marrëveshjen me KESH për balancim të rrjetit në mungesë të energjisë si rezultat i devijimeve të palëve.

ZRRE rikujton se, bazuar në Rregullën për të hyrat e OST/OT, nenit 12 dhe 13 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT-së, lejon të hyra për të mbuluar kostot e shërbimeve ndihmëse, sipas propozimit të OST, duke u siguruar se këto shërbime i janë nënshtruar prokurimit konkurrues apo do të marrë parasysh ndonjë dëshmi tjetër për të treguar se prokurimi i këtyre shërbimeve është bërë mbi bazë ekonomike.

Duke marrë parasysh faktin se KOSTT obligohet të zbatoj kodet operative të ENTSO-E dhe Marrëveshjen e Kyçjes me ENTSO-E, edhe pse mund të mos jenë në pajtueshmëri me kodet ekzistuese, dhe kodi i rrjetit të transmetimit është në fazën e plotësim ndryshimit, ZRRE në këtë fazë të monitorimit nuk do të ndërmarr ndonjë veprim rregullator në lidhje me këtë.

Bazuar në konstatimet e cekura më lartë, I PROPOZOJMË Bordit të ZRRE-së, që pas vlerësimit dhe analizimit të materialit të bashkangjitur, të konstatoj se ka bazë të mjaftueshme për aplikim e dispozitave ndëshkimore të përcaktuara me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe dispozitat e Rregullit për Masat Administrative dhe Gjobat.